




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-3682/13
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot. No.	
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	01.11.2013
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2622/13, për z. Abdylatif Latifi – Drejtor i Spitalit Rajonal të Gjilanit, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-2622-13, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrтарin e lartë, z. Abdylatif Latifi – Drejtor i Spitalit Rajonal në Gjilan - Ministria e Shëndetësisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Te rasti me numër protokoli AKK-03-2622/13, i hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë publik, z. Latifi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (DPKI-01-2760/13) pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Latifi është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë z. Latifi në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-3319/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte të ndërmarrja Ordinanca Mjekësore “Dr. Lata”, për të ushtruar funksionin e tij zyrtar si Drejtor i Spitalit Rajonal në Gjilan.

Zyrtaret e Agjencisë po ashtu i kanë rekomanduar z.Latifi që të ketë parasyshë gjithmonë nenin 13 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit i cili obligon zyrtarët e lartë që të bëjnë deklarin rast për rast të interesave të tyre private. Neni 13 paragrafi 1, shprehimisht thotë:

”Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

